

RAPORTI I
VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS
TE AKTIVITETIT:
“PERPUNIM ALUMINI”

Subjekti: “ALB-ORIENT” sh.p.k

Vendndodhja: Fshati Vaqarr, komuna Vaqarr, qarku Tirane

Pergatiti materialin : “Eko- Studio- Projekt” sh.p.k

Tirane, 2015



HYRJE

Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobesive ne menyre te pashmangshme krijon dhe “produkte” qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrueshem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proces. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qe eshte bere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale.

Materiali qe paraqitet trajton ndikimet ne mjedisin fizik dhe human te aktivitetit:

“Perpunim alumini”

Raporti i *Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis* siguron qe ndikime mjedisore te rendesishme jane vleresuar dhe marre ne konsiderate ne menyre te kenaqshme ne planifikim,

Ne kete raport *Vleresimi Ndikimi ne Mjedis* eshte trajtuar aktiviteti:

“Perpunim alumini “

BAZA LIGJORE

Relacioni u përgatit ne zbatim te akteve ligjore dhe nenligjore Mjedisore :

- *Ligji Nr.10 431, date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”*
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »*
- *Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis »*
- *Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes”*
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedis te caktuara”*
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”*
- *Ligji nr. 8897 dt. 16.05.2002 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”*
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”*
- *Vendim nr.805 date 4.12.2003 « Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore »*
- *Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave »*
- *Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjesemarrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis »*
- *Udhezim nr.3 date 19.11.2009 ‘Per metodologjine e raportit te VNM’*
- *VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mejdisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja ».*

1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

➤ Profili i propozuesit

Shoqeria ““ALB-ORIENT” sh.p.k” sh.p.k me administrator **Z.Iljaz Gega**, është themeluar me date **09/12/2003** dhe rregjistruar ne rregjistrin tregtar me date **16/12/2003** me nipt **K32416002K** .

Me pergatitjen e dokumentacionit perkates subjekti kerkon te pajiset me Leje Mjedisore te Tipit B sipas *VKM nr.419 date 25.6.2014* « *Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mejdisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja.* »

✚ Përshkrimi i Subjektit

Lënda e parë që vjen nga brenda vendit, nga pikat e ndryshme të grumbullimit të skrapit. Me anë të kamionëve ato mgazinohen në magazinë ku bëhet seleksionimi dhe ndarje e tyre në mënyrë manuale. Pas bëhet seleksionimi, ato dërgohen për në furrën e djegies e cila ka një temperaturë mbi 1000 gradë Celsius ku ndodh shkrirja e tyre. Në furrë futen një sasi kripe e cila bën të mundur uljen e temperaturës të shkrirjes së skrapit. Pasi ndodh shkrirja, prodhohen lingotat(në formë buke) të cilat tregtohen më pas për qëllime të ndryshme të klientëve.





Në pjesën e jashtme të instalimit është vendosur filtri i cili bën të mundur filtrimin e ajrit i cili është i përbërë nga:

- Dhoma e hidrociklonit
- Dhoma statike e ajrit
- Pjesa e daljes së ajrit të pastër
- Pjesa e daljes së gëlqeres së ndotur.



2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI

- **Trashegimia kulturore**

Nga konstatimi ne zone, territori ne studim nuk ndodhet ne distanca te aferta me zonat e mbrojtura nga Instituti i Monumenteve te Kultures se Tiranes. Ne zonen ku ndodhet impianti nuk ka objekte arkitektonike, arkeologjike, kulturore dhe me interesa historike.

- **Klima**

Klima e rajonit eshte mesdhetare fushore qendrore me karakteristikat klimaterike te rajonit te Shqiperise Perendimore. Zona dallohet per dimra te bute me karakteristika te theksuara mesdhetare dhe vetem ne raste te rralla ashpersia e dimrit eshte e ndjeshme. Temperatura mesatare vjetore leviz nga 15-16 grade celcius. Lageshtia mesatare relative arrin ne rreth 70%. Era fryn pergjithesisht ne dy drejtime gjate gjysmes se ftohte te vitit, ku vihet re se mbizoterojne ererat juglindore, pa perjashtuar ererat veriore. Ndersa ne gjysmen e ngrohte te vitit mbizoterojne ererat veriperendimore.

- **Popullsia ne afersi**

Ky projekt nuk ndikon ne popullsi per pasojë nuk ka ndikime pasuese mjedisore. Ne këtë aktivitet janë punësuar punonjës, nga zona rreth objektit. Kjo ndikon sadopak në zbutjen e papunesisë.

- **Flora dhe vegjetacioni**

Tirana ben pjese ne brezin e shkurreve dhe drure mesdhetare, ne kete zone vazhdojne te mbijetojne shkurre si mareja, driza, shqopa, murrizet etj. Zona eshte pergjithesisht e zhveshur nga bimesia ne afersi te saj ndodhen edhe objekte te tjera ku ushtrojne aktivitet edhe biznese te tjera

Flora: Zona ku është ndërtuar fabrika, perfaqesohet nga depozitime Flishore te Oligocenit, flishoidale te Akitanianit N1 dhe aluvjalo – proluvjonet te quaternarit te cilat perfaqesojne berthamen e vargut sinklinal Kruje Dajt. Kjo sipërfaqe nuk përbën pjesë në zonat e mbrojtura me status të vecantë. Kjo sipërfaqe është një sipërfaqe e varfër përse i përket florës ne te rritet bimesi e ulet e mbuluar me barishte midis tyre. Nuk ka bime

endemike, te kercenuara apo rrezikuara si dhe nuk ka specie bimore te mbrojtura nga konventa ku ben pjese vendi yne. Flora behët më e larmishme duke u larguar nga objekti ne zonen fushore ku kultivohen fruta dhe perime te zones.

Fauna: Zona e Tiranes dallohet edhe per pasurite e botes shtazore si rrjedhoje e pozicionit gjeografik e larmise se klimes. Në këtë zonë mund të takosh lloje te ndryshme te klases se shpendeve megjithese ne numer te vogel si dhe disa lloje te invertebrorve. Takohen shpende si harabeli, mellenjat, gushkuqi dhe gjitarë si lepuri, minj, nuse lales (Mustela vivalis) etj.

- **Hidrologjia , ujerat siperfaqesore dhe nentokesore**

Ne kete rajon takohen ujerat nentokesor ne depozitat zhavorr. Pasqyra e nivelit te perhershem te ujrave nentokesore luhaten sipas rreshjeve. Ne zonen ku zhvillohet aktiviteti verehet se nuk ka burime siperfaqesore ne distanca te aferta. Gjithashtu nuk ka zona te lundrueshme dhe nuk ndodhen liqene apo dete, prandaj gjate zhvillimit te aktivitetit nuk do te cenohen rruget ujore, brigjet bregdetare.

- **Gjeologjia**

Shqiperia si formacion gjeologjik eshte pjese perberese e rrudhosjeve alpino-mesdhetare pjese e degezimit dinaro-albano-helenid, ku ne bejme pjese tek albanidet. Tirana si zone e jashtme ben pjese ne ultesiren paramalore dhe karakterizohet nga shkembinj te dobet qe i ben te paqendrueshem nga rreshqitja dhe eshte pjese e sistemit neogjenik argjila, konklomerat ranor. Zona karakterizohet nga brezi i tokes se hirte kafe, ku ajo vendoset mbi formacione sedimentare dhe sasia e humusit eshte e vogel.

3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS

Nje nga objektivat eshte edhe identifikimi i ndikimeve te mundshme qe mund te shkaktohen ne mjedis nga ky aktivitet ne teresi. Identifikimi i ndikimeve te mundshme ne mjedisin e kesaj zone do te vleresohen gjate fazes se funksionimit te aktivitetit.

o Ndikimet ne popullsi

Realizimi i projektit nuk do te kete ndikime ne levizjen apo zhvendosjen e popullsisë se rajonit ku do zbatohet projekti. Gjate funksionimit te impiantit nuk ka emetime ne ajer, toke apo uje te cilat ndotin ambjentin dhe te rrezikojne shendetin e punonjesve apo te popullsisë se rajonit.

o Ndikimet ne toke

Aktiviteti nuk gjeneron mbetje te ngurta te rrezikshme qe te demtojne mjedisin.

o Ndikimet ne ajer

Ndikimi i ketij aktiviteti ne ajer do te jete vetem ne sistemin e aspirimit te ambjentit te punes dhe te sistemit ftohes te produktit te derdhur me metal. Ajri i nxjerre ne atmosfere nga aspiratori, nuk do te kete perberje te demshme, vleresohet vetem nje rritje e lehte e temperatures se ajrit nga ftohja e materialit te derdhur me metal te shkrire. Ne pjesen e fuures futet kripe me qellim uljen e temperatures se saj. Ne pjesen e brendshme te aspiratorit futet gelqere me qellim pastrimin e ajrit. Ne pjesen e jashtme jane vendosur filtraat e oxhakut.

o Ndikimet ne ujera

Aktiviteti ne vleresim nuk perfshine procese me pranine e ujit. Procesi punes kryhet ne te thate, nuk ka procese larje dhe pastrim te ambjentit te punes, nuk ka derdhje tematerialeve te paperdorshme. Metali i mbetur nga procesi, riciklohet duke u riderdhur ne furren e prodhimit. E vetmja sasi uji qe perdoret eshte, uji qe ftoh pjesen e makinerise. Ujerat e perdorura jane vetem ato te ambjenteve higjeno-sanitare te tualeteve, kuzhines dhe ujerat kulluese te ujerave te shiut.

o Ndikimet ne klime



Gjate zhvillimit te aktivitetit nuk priten ndryshime te dukshme klimaterike, si ne drejtim te permiresimit ashtu edhe ne ate te perkeqesimit te saj. Nuk do kete ndryshime ne temperature, ne drejtim te eres, ne sasine e reshjeve. Pra kryerja e ketij aktiviteti nuk ndikon fare ne kushtet klimaterike te kesaj zone.

○ *Ndikimet ne floren dhe faunen*

Zona në të cilën ushtrohet aktiviteti është një zonë në të cilën nuk takohen elemente te spikatur te flores. Perreth kësaj zone, mund te hasim bimesi te ulet dhe barishte te ndryshme. Aspekti faunistik i lidhur ngushte me mjedisin rrethues ketu paraqet nje larmi biologjike te varfer, qe eshte po keshtu nje pasqyrim i gjendjes se ketij ekosistemi tashme te degraduar.

○ *Ndikimet nga zhurmat*

Zhurmat emetohen ne pjesen e brendshme te godines ku zhvillohet aktiviteti nga pajisjet e punes. Mund te themi se zhurmat jashte ambjenteve te punes jan e Brenda normave te lejuara.

4. MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE

Me qellim minimizimin e efekteve negative mjedisore dhe rritjes se efekteve pozitive ne mjedis, nga ana e shoqerise do te sigurohet marrja e masave si me poshte:

 ***Territorri perreth impiantit***

I gjithe territori i impiantit dhe sheshet e levizjes jane te shtruara dhe te sistemuara. Nga shoqeria jane marre masa edhe per gjelberimin e territorit perreth impiantit duke bere te mundur mbjelljen me peme , gjithashtu nga stafi tregohet kujdes per mbajtjen paster te ambientit dhe sperkatjen e tij here pas here me uje.

Rastet aksidentale

Do merren masat per parandalimin e tyre, pajisjet ne fabrike do kontrollohen vazhdimisht per gjendjen teknike te tyre. Shoqeria siguron se do kete nderhyrje te menjehershme nese do te kete ndikime negative ne mjedis.

Kushtet e punes

Persa i perket sigurimit teknik te punonjesve ata do jene te mire informuar mbi rregullat e sigurimit teknik gjate kryerjes se punes, konform rregulloreve perkatese per mbrojtjen e jetes dhe shendetit. Gjithashtu shoqeria do ti pajise me uniforma dhe mjete mbrojtese.

Vleresimi i efektivitetit te pritshem te masave zbutese

Realizimi i objektivave dhe treguesve te pritshem te parashikuar do te varet nga respektimi i te gjitha treguesve te percaktuar. Kontrolli dhe permiresimi i vazhdueshem i kushteve te punes ne shoqeri do te çojne perfundimisht ne nje proces pune te kontrolluar me shkarkime brenda normave, duke mos sjelle pasoja per shendetin e njerezve dhe mjedisin perreth.

KONKLUZIONE

- Ky aktivitet prodhues nuk demton habitate dhe nuk prish ekuilibrat biologjike-natyrore.
- Zbatimi i masave te projektit per mbrojtjen e mjedisit dhe ato pak elemente ndotes qe kemi permendur me siper qe mund te kene ndikim te vogel ne ambient do te eliminohen.
- Mbajtja paster e mjedisit te zones se operimit, do te jete detyre e perhershme e subjektit per te garantuar nje mjedis te paster ne territorin e zones ku kryhet aktiviteti. Jane mbjelle peme perreth impiantit.
- Per nje pune sa me optimale në impiant zbatohen rregullat e sigurimit teknik dhe puntoret e manovratoret njihen me keto rregulla ne menyre periodike nga drejtuesit teknik te firmes.

❖ **REKOMANDIME**

- Te merren masa dhe te kryhet reabilitimi i mjedisit ne rastet e ndonje aksidenti.
- Te kryhet rregullisht kontrolli gjendjes teknike te agregateve dhe mjeteve te transportit si dhe te mjeteve te punes.
- Te njihen punonjesit periodikisht me rregullat e sigurimit teknik, si dhe me efektet pluhurave, zhurmave, vibrimet etj në jetën e tyre të përditëshme si dhe të merren masat e duhura për monitorimin në vazhdimësi të tyre me aparaturat dhe instrumentet e nevojshme.

Per “EKO - STUDIO - PROJEKT” sh.p.k

Ing. Xhevair DERMYSHI